



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport Konsultativ

Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KEDS

(Prill 2019 - mars 2020)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesit.
Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

Mars 2019



Përmbajtja

1	Hyrje	3
2	Përshtatja e të Hyrave të Lejuara Maksimale	4
3	Bilanci i Energjisë Elektrike	4
3.1	Vlerësimi i Bilancit të Energjisë Elektrike të Realizuar dhe të Parashikuar	4
4	Përshtatjet e rregullta	6
4.1	Përshtatjet për normën e inflacionit	6
4.2	Përshtatjet për kostot e bartshme	6
4.3	Përshtatjet e kostove të humbjeve	6
4.4	Përshtatjet për të hyrat jo tarifore	8
4.5	Përshtatjet për faktorin korigjues të të hyrave	8
5	Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së	10



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aktualisht është duke kryer Përshtatjen e Rregullt dhe procesin e Azhurnimit Vjetor për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbulohen nga Kompanitë e Rregulluara. Në këtë proces, ZRRE-ja do të aprovojë MAR të azhurnuar për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH, KEDS) dhe Furnizuesin me Shërbime Universale të Energjisë Elektrike (FSHU), bazuar në propozimet e dorëzuara nga Kompanitë e Rregulluara si dhe vendimeve për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën rregullative 2018-2022. Këto më pas do të përdoren nga Kompanitë e Rregulluara për të propozuar tarifat e tyre për këtë vit që do të jenë efektive nga data 1 prill 2019.

Rregullimi i Çmimit është mjet që përdoret nga ZRRE në mënyrë që të përcaktohen Të Hyrat e Lejuara Maksimale – MAR, të cilat Kompanitë e Rregulluara do ti mbledhin për ofrimin e shërbimeve të rregulluara. MAR caktohet në nivelin që mundëson të licencuarit e rregulluar t'i mbulojnë kostot e arsyeshme operative dhe të mirëmbajtjes së aseteve të tyre dhe të realizojnë kthim të arsyeshëm në investimet e tyre. Gjithashtu, ZRRE përcakton caqe të efikasitetit, të cilat synojnë ngritjen e efikasitetit operativ të kompanive dhe të ofrojnë nxitje për arritjen e caqeve apo ndëshkime nëse kompanitë dështojnë t'i arrijnë ato.

Vlerat bazë për komponentët e MAR janë përcaktuar në Shqyrtimin Periodik të bërë në vitin 2018 dhe mbesin të vlefshme për një periudhë pesëvjeçare. Shqyrtimi aktual ka të bëjë me vlerësimin e propozimeve për MAR të paraqitura nga Kompanitë e Rregulluara dhe përshtatjen e tyre me vlerat bazë për vitin relevant tarifar 2019. Ky shqyrtim vlerëson nëse propozimet e të licencuarve janë llogaritur në përputhje me kërkesat ligjore.

ZRRE fton kompanitë e rregulluara, konsumatorët dhe të gjitha palët tjera të interesit, që të japin kontributin e tyre në këtë proces, duke shqyrtuar dhe komentuar të dhënat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë Raport Konsultativ, në mënyrë që vlerësimi të jetë i saktë për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.

Palët të cilat dëshirojnë të paraqesin komentet e tyre eventuale rreth propozimeve të ZRRE-së ftohen që të dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në postën elektronike ero.pricing-tariffs@ero-ks.org jo më vonë se **8 mars 2019**. Gjithashtu, komentet mund të dërgohen me postë në:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12, Prishtinë, 10000, Kosovë

Dokumentet Relevante

Vlerësimi përfundimtar i MAR të OSSH në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	http://ero-ks.org/2018/Raportet/Pergjigje%20ndaj%20komenteve%20te%20KEDS_PRR2_final.pdf
Aplikacioni i KEDS-it për vitin 2019	http://www.ero-ks.org/2019/Tarifat/Aplikimi_i_OSSH_per_MAR_viti_2019.pdf



2 Përshtatja e të Hyrave të Lejuara Maksimale

ZRRE, bazuar në Rregullën për Vendosjen të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH, ka pranuar aplikacionet dhe ka analizuar me kujdes të gjithë komponentët e kostove dhe kërkesat e të licencuarit. Gjatë procesit të Përshtatjes së Rregullt, ZRRE përdor rezultatet e marra gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik 2018-2022 dhe përshtat MAR për të reflektuar ndryshimet në mes të kostove që kanë qenë të parashikuara gjatë Shqyrtimit Periodik dhe kostove aktuale të shkaktuara nga Kompanitë e Rregulluara për shkak të arsyeve që janë jashtë kontrollit të tyre. Gjatë këtij procesi ZRRE do të:

1. Indeksojë Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes për Faktorin e Efikasitetit i cili caktohet gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik dhe për Inflacionin Vjetor i cili caktohet duke përdorur Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumit (HICP) për vendet e Eurozonës;
2. Caktojë Kostot e Lejuara të Humbjeve (LSSCt) për OSSH, dhe t'i azhurnojë këto në mënyrë që të përfshijnë ndryshimin në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të humbjeve për Periudhën paraprake Rregullative, të cilat mund të kenë ndodhur si rezultat i ndryshimeve në kostot e blerjes së energjisë me shumicë apo i ndryshimeve në rrjedhat e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes;
3. Azhurnojë MAR-in e OSSH-së në mënyrë që të reflektojë ndryshimin në mes të të Hyrave të Lejuara dhe të Realizuara në Vitin paraprak Relevant (t-1), duke përfshirë edhe të hyrat e përjashtuara;
4. Caktojë MAR-in e OSSH-së për Vitin Relevant t.

3 Bilanci i Energjisë Elektrike

ZRRE ka përdorur bilancin e azhurnuar nga KEDS për të marr parasysh konsumin e përditësuar dhe vlerësimin për derrgullimin e konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 35kV. Implementimi i ndryshimeve ligjore në kuadër të liberalizimit të tregut ka një ndikim esencial në trajtimin e humbjeve në sistemin e energjisë elektrike. Bilanci i azhurnuar do të përdoret për të llogaritur blerjet e energjisë me shumicë për mbulimin e humbjeve të transmetimit, shpërndarjes dhe tarifën me pakicë për Shërbimin Universal.

3.1 Vlerësimi i Bilancit të Energjisë Elektrike të Realizuar dhe të Parashikuar

Me qëllim të vlerësimit të kostove që kanë të bëjnë me blerjen e humbjeve në nivel të OSSH-së, ZRRE ka analizuar të dhënat e raportuara nga KEDS për vitin 2018 dhe të dhënat për parashikimin e bilancit për vitin 2019. Analiza e bilancit të realizuar për vitin 2018 dhe atij të parashikuar për vitin 2019 është paraqitur në tabelën në vijim:



Tabela 1: Bilanci i energjisë elektrike

Bilanci i energjisë elektrike ne OSSH	Njësia	Realizimi 2018	Propozimi 2019
Hyrja ne OSSh	GWh	5,120	5,048
Energjia e pafaturuar në Veri	GWh	272	259
Hyrja në OSSh pa energjinë e pa faturuar	GWh	4,848	4,789
Hyrja në OSSh pa energjinë e pa faturuar	%	5.3%	5.1%
Humbjet teknike dhe komerciale në OSSh	GWh	1,157	949
	%	22.6%	18.8%
Gjithsej humbjet	GWh	1,429	1,208
	%	27.9%	24.1%
Energjia e mbetur për faturim	GWh	3,691	3,840
Faturimi nga KEDS	GWh	3,640	3,840
Rikthimi i humbjeve	GWh	51	-

Viteve të fundit, pas ndryshimit të strukturës tarifore kemi një trend të ngritjes së konsumit të energjisë elektrike. Kjo rritje e konsumit vjen si pasojë e heqjes së blloqeve tarifore dhe dallimeve sezonale. Kështu në vitin 2017 kishim një rritje të konsumit prej 6.4% në raport me vitin 2016, ndërsa në vitin 2018 kemi rritje të konsumit për 4.5% në raport me vitin 2017. Nga parashikimi i konsumit për vitin 2019 shihet që trendi i rritjes do të vazhdoj edhe më tej. Megjithatë, nëse niveli i humbjeve realizohet sipas lejimeve të ZRRE, atëherë mund të pritët që konsumi bruto të mbetet në nivele të përafërta me vitin 2018. Caku i humbjeve në shpërndarje, i lejuar nga ZRRE për vitin 2019 është 18.8%.

KEDS në aplikacionin e tij ka kërkuar që vetëm 20% e kostove që rezultojnë nga faturimi i energjisë për rikthimin e humbjeve të mirret parasysh, për arsye të pamundësisë së arkëtimit të tyre, si pasojë e vonesave të procedurave gjyqësore. Rikthimi i humbjeve sipas raporteve të KEDS si dhe verifikimit të ZRRE, rezulton të jetë prej 51 GWh energji elektrike, kjo vlerë është përdorur gjatë kalkulimit të të hyrave të realizuara nga shitjet.

ZRRE konsideron që kostoja që rezulton nga faturimi i kësaj energjie duhet të trajtohet si e hyrë e tërësishme, sepse kjo trajtohet me parimin e aktualitetit, ku të hyrat njihen në momentin e faturimit dhe jo atëherë kur arkëtohen. Për më tepër, duhet theksuar se kjo vlerë e energjisë prej 51 GWh është përfshirë në energjinë e hyrë në rrjetin e shpërndarjes nga e cila bazë janë kalkuluar kostot e humbjeve të energjisë, prandaj njohja si kosto e kësaj energji nënkupton edhe njohjen e të hyrave që rezultojnë nga kjo energji.

Nga tabela e mësipërme vërehet që humbjet e veriut janë të paraqitura si rrjedha fizike dhe përdoren për qëllime të barazimit të bilancit të energjisë elektrike. Sidoqoftë, kostot që rrjedhin nga



furnizimi i katër komunave veriore të Kosovës nuk përfshihen gjatë kalkulimit të kostove të furnizimit me energji. Aktualisht kjo energji është duke u siguruar nga tërheqjet e sistemit të interkoneksionit dhe kjo energji është duke u akumuluar si borxh i KOSTT-it ndaj ENTSO-E.

4 Përshtatjet e rregullta

Në këtë pjesë janë paraqitur kalkulimet lidhur me përshtatjet e rregullta vjetore të vitit 2018. Kalkulimi i këtyre përshtatjeve do të përfshihet gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale për vitin relevant tarifor 2019.

4.1 Përshtatjet për normën e inflacionit

Për të bërë kalkulimin e përshtatjeve lidhur me normën e inflacionit si referencë është marr norma e inflacionit e publikuar nga Eurostati për vendet e Eurozonës, e cila për vitin 2018 ishte 1.73%¹. Mënyra për kalkulimin e përshtatjeve të tilla është e përcaktuar në Rregullën e të Hyrave të OSSH-së.

Kjo normë aplikohet në përshtatjen e kostove operative, kostove të zhvlerësimit dhe kthimit në kapital. Pas aplikimit të normës së inflacionit prej 1.73% ndaj komponenteve të kostove të sipërpërmendura, rrjedh vlera e kostove të përshtatura prej 0.87 milion euro. Përshtatjet që kanë rezultuar nga aplikimi i normës së inflacionit për secilën nga komponentët e kostove të lejuara në vitin 2018 janë shtuar më pastaj vlerësimit fillestar të kostove të vlerësuara për vitin 2019. Detajet e këtyre kalkulimeve janë paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 2: Përshtatjet për inflacion

Linja	Njësia	a) Lejuar 2018	b) Përshtatja për HICP	c) Vlerësimi fillestar 2019 ²	d=b+c Lejimi 2019
OPEX-i	mil€	26.18	0.45	25.85	26.30
Zhvlerësimi	mil€	12.23	0.21	14.44	14.65
Kthimit	mil€	11.72	0.20	13.39	13.59
Total	mil€	50.13	0.87	53.68	54.54

4.2 Përshtatjet për kostot e bartshme

Për shkak të dallimeve ndërmjet energjisë së parashikuar dhe asaj të realizuar nga OSSh lidhur me obligimet e OSSh ndaj Operatorit të Tregut (OT) dhe Operatorit të Sistemit (OS), janë bërë përshtatjet për të reflektuar këto dallime. Vlera e këtyre përshtatjeve është -0.27 milion euro.

4.3 Përshtatjet e kostove të humbjeve

Përshtatja e kostos së humbjeve për OSSH bëhet përmes formulës së mëposhtme:

$$(LSSCat-1 - LSSCft-1) * (1 + It)$$

¹ https://www.ecb.europa.eu/stats/ecb_statistics/ecsb/html/table.en.html?id=JDF_ICP_COICOP_ANR&period=2017-12

² Sipas lejimeve të Shqyrtimit Periodik 2018-2022 linku:

http://ero-ks.org/2018/Raportet/Pergjigje%20ndaj%20komenteve%20te%20KEDS_PRR2_final.pdf



Vlera e kostos së përshtatur për humbje është 8.68 milion euro, e cila rezulton për shkak të rrjedhave më të mëdha të energjisë të realizuara kundrejt atyre të parashikuara dhe çmimit mesatar më të lartë për blerjen e humbjeve për vitin 2018 në rrjetin e shpërndarjes. Detajet e kalkulimeve janë dhënë në tabelën më poshtë.

Tabela 3: Përshtatjet për kostot e humbjeve

OSSH MAR	Njësia	E lejuar 2018	E realizuar 2018	E propozuar 2019
Parametri i indeksimit				
I_t	%		7.49%	
Humbjet e lejuara (LSSCt)				
LSSAt	%	18.8	18.8	18.8
REUEt	GWh	4,539.5	5,120.1	5,048.3
WHEAt	€/MWh	44.00	47.40	42.97
LSSCat-1	mil€		45.63	
LSSCft-1	mil€	37.55		40.78
Kostot e përshtatura³	mil€		8.68	

Ku :

$LSSA_t$ janë humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t

$REUE_t$ janë njësitë e energjisë (MWh) apo (GWh) që hyjnë në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t

$WHEA_t$ është mesatarja e kostos me shumicë të energjisë (€/MWh) në vitin relevant t

$LSSCa_{t-1}$ është kostoja e realizuar e humbjeve të lejuara në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)

$LSSCf_{t-1}$ është kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)

I_t është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 5%, ku S paraqet vlerën që do përcaktohet nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra mbi normën e EURIBOR-it

Parashikimi i çmimit mesatar për humbje për vitin 2019 është bërë duke indeksuar çmimin aktual të gjenerimit nga KEK-u për normën e harmonizuar të inflacionit prej 1.73% dhe parashikimin e çmimit të importit bazuar në çmimet aktual të realizuara si dhe çmimet referente në bursat regionale.

³ këto kosto janë pjesë e azhurnimeve të përgjithshme dhe reflektohen në MAR-in e vitit 2019.



4.4 Përshtatjet për të hyrat jo tarifore

Të hyrat të tjera të realizuara nga aktivitetet e pa-rregulluara siç janë: të hyrat nga dhënia me qira e aseteve, të hyrat nga operatorët e ndryshëm ekonomik, shitja e aseteve, shërbimet e ndryshme ndaj konsumatorëve, etj, zbriten nga të hyrat e lejuara maksimale. Vlera e këtyre të hyrave të realizuara nga OSSh në vitin 2018 është raportuar nga KEDS-i të jetë 6.6 milion euro, mirëpo ZRRE ka marr vlerën e realizuar e të hyrave nga shërbimet e përjashtuara nga draft pasqyrat financiare të dërguara në ZRRE të cilat janë 10 milion euro. Dallimi kryesor është se KEDS nuk ka paraqitur të hyrat e realizuar nga jo-balancet e energjisë.

Lidhur me trajtimin e jo-balanceve të energjisë, ZRRE ka sqaruar edhe në shqyrtimin e kaluar se këto të hyra kanë rezultuar nga nominimet dhe jo nga balancimi i sistemit. Balancimi i sistemit është përgjegjësi e KOSTT, dhe për këtë qëllim ZRRE ka lejuar kostot e balancimit. Menaxhimi, përkatësisht balancimi i sistemi bëhet në parim të kërkesës dhe ofertës, për të mundësuar këtë funksion në kuadër të OST/OT-së është i themeluar mekanizimi balancues. Kur do që ka dallime në sistem ndërmjet kërkesës dhe ofertës, OST aktivizon mekanizmin e tillë me qëllim të balancimit të sistemit, kjo bëhet përmes aktivizimit të shërbimeve ndihmëse apo përmes DMS.

Nga ajo që u theksua më lartë, të hyrat e realizuara nga KEDS nga “jo-balancet e energjisë” nuk paraqesin kostot që kanë të bëjnë me balancimin e sistemit, por ato kanë rezultuar nga aspektet e nominimit. Bazë për trajtimin e këtyre të hyrave si të hyra jo tarifore, është se këto të hyra janë realizuar jashtë tarifave për shfrytëzimin e rrjetit të shpërndarjes, nga aplikimi i të cilave duhet të realizohen të hyrat e rregulluara. Çdo e hyrë jashtë kësaj kornize trajtohet si e hyrë jo tarifore, trajtimi i këtyre të hyrave është i paraparë edhe në Rregullën e të Hyrave të OSSH-së:

$$MART = OPMct + DEPCt + RTNct + LSSct + LICct - NTFR t + ADJt + KREVt$$

Siç shihet edhe nga shprehja e mësipërme, të hyrat jo-tarifore trajtohen si të hyra të zbritshme gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale. Korigjimi i këtyre kostove/të hyrave mund të bëhet edhe përmes faktorit korigjues të të hyrave $KREV_t$.

Sa i përket shqetësimit të ngritur në aplikacionin e KEDS lidhur me jo-balancet e vitit 2017, ZRRE pret nga KEDS që në kuadër të këtij procesi të konsultimit të ofrojë të dhënat lidhur me energjinë, çmimin mesatar dhe koston e realizuar në vitin 2017 nga OSSh për mbulimin e humbjeve për të gjithë periudhën (janar – dhjetor të vitit 2017).

Duhet të theksuar se kostot apo të hyrat që rezultojnë nga mekanizimi balancues do të trajtohen në kuadër të të hyrave tjera jo-tarifore. Kjo çështje do të vazhdojë të trajtohet në këtë mënyrë duke bartur kostot apo kompenzimet te konsumatorët në këto kushte të tregut dhe kornizës aktuale rregullative.

4.5 Përshtatjet për faktorin korigjues të të hyrave

Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale është bërë korigjimi i të hyrave të vitit 2018. Parimi i cili aplikohet ka të bëjë me vlerësim e përgjithshëm të kostove të lejuara aktuale dhe të hyrave aktuale të realizuara. Këto llogaritje janë bërë sipas formulës në vijim:

$$KREV_t = (AAC_{ot-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$



Ku janë:

AAC_{at-1}	<i>Kostot e lejuara aktuale për vitin relevant t-1 ("Actual Alloed Cost as determined in Relevant Year t-1")</i>
ARR_{t-1}	<i>Paraqet të hyrat e realizuara në vitin relevant t-1 ("is the Actual Regulated Revenues in Relevant Year t-1")</i>
I_t	<i>Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua afatshkurtra</i>

Ndryshimi në mes të AAC_{at-1} prej 84.8 mil€ dhe ARR_{t-1} prej 80.2 mil€, pas aplikimit të normës së interesit rezulton të jetë 4.98 mil€. Ky ndryshim ndërmjet të hyrave dhe kostove aktuale të lejuara bartet si azhurnim gjatë përcaktimit të MAR për vitin 2019.



5 Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së

Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH janë llogaritur sipas formulës në vijim:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LSSC_t + LICC_t - NTFR_t + ADJ_t + KREV_t$$

Ku

MAR_t janë të hyrat e lejuara maksimale në vitin relevant t

$OPMC_t$ janë kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t

$DEPC_t$ është zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t

$RTNC_t$ është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t

$LSSC_t$ është kostoja e lejuar e humbjeve në vitin relevant t

$LICC_t$ është kostoja e taksës për licencë në vitin relevant t

ADJ_t është përshtatje e kostove

$KREV_t$ është faktori i korrigjimit të të hyrave në vitin relevant t

Llogaritja e secilit nga këta komponentë është shtjelluar më poshtë.

Tabela 1 Propozimi i MAR të OSSH (KEDS) pas përshtatjeve

OSSH MAR		2018 E lejuar	2018 E realizuar	2019 e vlerësuar (PRR2)	2019 Propozuar
Parametrat e indeksimit					
Faktori i efikasitetit	%			1.5%	
HICP	%		1.73%		
Euribor	%		-0.11%		
S-factor	%		7.6%		
It	%		7.49%		
Kosto operative dhe e mirëmbajtjes (OPMCT)					
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	26.18	26.18	25.85	26.30
Kostoja e licencës			0.09		
Kostot e përjashtuara				-0.41	
Zhvlerësimi i lejuar (DEPCt)					
$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	12.23	12.23	14.44	14.65
Kthimi i lejuar (RTNCt)					
$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	11.72	11.72	13.39	13.59
Obligimet për OS dhe OT					
Obligimet për OS dhe OT	€m	0.79	0.54	-	1.13
Humbjet e lejuara (LSSCt)					
LSSAt	%	18.80	18.80	18.80	18.80
REUET	GWh	4,539.1	5,120.1	4,641.7	5,048.3



WHEAt	€/MWh	44.00	47.40	40	42.97
LSSCat-1			45.63		
LSSCft-1	€m	37.55		34.91	40.78
LSAct-1					
LSSCt					
Azhurnimet					
Të hyrat e parregulluara	€m	-3.50	-10.05	-3.50	-3.50
Përshtatjet e PRR1 dhe vitit 2017					
Përshtatjet	€m	-1.50	-1.50	-1.50	-1.50
OSSH MAR					
MAR-i fillestar	€m	83.46	84.82	83.18	
KREV					
AAC _{t-1}	€m		84.82		
ARR _{t-1}	€m		80.19		
KREV_t = (AAC_{t-1} – ARR_{t-1}) * (1+ It)	€m		4.98		
KREV_{t-1}	€m				4.98
MAR-i final	€m				96.44

Si rezultat i kalkulimeve të secilit komponent të kostove, MAR i propozuar për OSSH për vitin 2019 është 96.44 milion €.